

Laci/ Alfred Zefi: Jam drejt permisimit

nga AlbaniaSoccer

E martë, 26 Nentor 2013 04:32



Lajme pozitive vijne nga kampi lacian. Gjendja shendetsore e futbollistit, Alfred Zefi eshte ne permisim e siper. Nje fakt te tille e ben e ditur burimet prane klubit lacian. Futbollisti ka qendruar per pak kohe ne spitalin Amerikan ne kryeqytet ku eshte mjekuar dhe eshte kthyer prane familjes. "Jam drejt permisimit. Tashme pres nje kontroll te dyte per te percaktuar kohen e qendrimit jashe fushes se lojes", u shpreh vete futbollistiper Albaniasoccer.com. Sipas vete futbollistit mesojme se kontrolli i dyte do te zhvillohet ditën e marte paradite. Futbollisti lacian pesoi nje demtim si rezultat i dyluftimit me futbollistin e Tiranës , Semedos. Ndeshja mes tyre ka perfunduar me fitoren e skuadres laciane me rezultatin e ngushte 1-0